

---

# STATUT

## I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

### “ENOLIO” SHPK

Mbeshtetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil në Fuqi të Republikës së Shqiperisë, ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për shoqeritë tregtare”(ndryshuar) dhe ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Q.K.R” (ndryshuar) dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqeritë Tregtare për regjistrimin dhe organizimin e tyre;

- Sot më datë 30.05.2017, unë i nënshkruari, Endrit Shabani, me vullnetin tim të lirë, në cilësinë e Ortakut të vetëm të shoqërisë, vendos hartimin dhe nënshkrimin e Statutit të shoqërisë “ENOLIO” SHPK.

#### THEMELIMI, ZOTËRIMI, OBJEKTI I VEPRIMTARISË, SELIA

**Neni 1**  
**Emri**

- 1.1 Emri i shoqërisë është “ENOLIO” SHPK (më poshtë referuar si “Shoqëria”).

**Neni 2**  
**Ortaku**

- 2.1 Ortaku i vetëm themelues i shoqërisë është:

- a. **ENDRIT SHABANI** shtetas shqiptar, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, lindur më 24 Janar 1988, në Vlorë dhe banues në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i ID-s me Nr. Personal I80124005P.

**Neni 3**  
**Forma Ligjore**

- 3.1 Shoqëria ka formën e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, në përputhje me ligjin për shoqeritë tregtare në Republikën e Shqipërisë.
- 3.2 Shoqëria mund të transformohet në një formë tjeter ligjore në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 3.3 Shoqëria ka të drejtë të hapë degë apo filiale, zyra përfaqësimi, në të gjithë vendin gjatë aktivitetit të saj, brenda ose jashtë territorit të vendit.



---

**Neni 4**  
**Baza ligjore**

- 4.1 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj në përputhje me këtë Statut, Ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (“**Liqji i Shoqërisë Tregtare**”) dhe çdo dispozitë tjeter të zbatueshme të legjislacionit shqiptar.

**Neni 5**  
**Kohëzgjatja e Veprimtarisë**

- 5.1 Shoqëria krijohet për një afat të pacaktuar.

**Neni 6**  
**Selia/Adresa e Regjistruar**

- 6.1 Selia e Shoqërisë është: **Njësia Administrative Nr.1, Rruga “Niko Avrami”, Pasuria nr.7/434+2-N, Tiranë.**
- 6.2 Administratori mund të krijojë NIPT-e sekondare të Shoqërisë.

**Neni 7**  
**Objekti**

- 7.1 Prodhimi i energjisë duke perdorur energjine e gjelber si uje, burimet termike, burimet e eres, biogazit dhe fotovoltaikë. Ndertim dhe projektim hidrocentralesh studime te fizibilitetit, planit te bizneseve. Planifikimin, ndertimin, operimin, menaxhimin dhe financimin e furnizimit te decentralizuar te energjisë.

**Neni 8**  
**Kapitali**

- 8.1 Kapitali fillestari i Shoqërisë është 100.000 (*njeqindmijë*) Lek.

- 
- 8.2 Kapitali i shoqërisë është i ndarë në 1 pjesë (kuotë,) me vlerë nominale 100.000 (*njëqind mijë*) Lek.
  - 8.3 Kuota do të mbahet nga ortaku vetëm, i cili është zotëruar i 100 % të kapitalit të Shoqërisë.

### Neni 9

#### Transferimi i një pjese të kapitalit. Kufizimet mbi transferimin

- 9.1 Kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
  - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
  - b) shitblerjes;
  - c) trashëgimisë;
  - ç) dhurimit;
  - d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
- 9.2 Në rast se shoqëria do të ketë në të ardhmen më shumë se një ortak, atëherë do të lindë nevoja për ndryshimin e këtij statuti, në mënyrë që të pasqyrohen të drejtat dhe detyrimet e tyre si edhe mënyra e organizimit të shoqërisë me më shumë se një ortak.

### Neni 10

#### Zmadhimi i Kapitalit

- 10.1 Ortaku i vetëm mund të vendosë të rrisë kapitalin e shoqërisë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
- 10.2 Kontributet e ortakut mund të konsistonë në të gjitha format e aktiveve të lejuar nga ligji, duke përfshirë edhe kontributet në natyrë.
- 10.2 Detyrimet e ortakut kundrejt shoqërisë do të mbulohen vetëm me pjesën e kapitalit të paguar prej tij. Ortaku nuk do të ketë asnjë përgjegjësi tjetër për detyrime të tjera të shoqërisë.

### Neni 11

#### Zvogëlimi i Kapitalit

- 11.1 Zvogëlimi i kapitalit mund të kryhet në përputhje me të gjitha procedurat e parashikuara nga ligji shqiptar.

---

## STRUKTURA DREJTUESE

### Neni 12 Asambleja e Ortakëve

- 12.1 Organet e shoqërisë janë:
1. Asambleja e Ortakut të Vetëm të Shoqërisë.
  2. Administratori
- 12.1 Vendimet kryesore të veprimtarisë së Shoqërisë merren me vendim të Asamblesë së Ortakut, e cila është organi më i lartë i Shoqërisë, që ka të drejtën të miratojë vendime në lidhje me të gjitha çështjet e aktivitetit të saj.
- 12.3 Për mënyrën e drejimit dhe ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë, Ortaku i Vetëm shprehet me vendime për gjithcka që është në kompetencat e tij. Marrja e vendimeve të Ortakut të Vetëm regjistrohen në regjistrin e vendimeve. Mbajtja e procesverbaleve dhe të gjitha dokumentat e tjera që kane të bëjnë me të duhet të bëhen sipas legjislacionit në fuqi për këtë qëllim.
- 12.4 Vetëm Asambleja e Ortakëve do të ketë të drejtë të vodos për çështjet e mëposhtme:
- a. modifikimin dhe ndryshimin e këtij Statuti;
  - b. te vodosë për emërimin dhe shkarkimin e administratorëve të Shoqërisë;
  - c. të zmadhojë dhe/ose zvogëlojë kapitalin e regjistruar;
  - d. vodosë për shkrirjen, prishjen, likuidim dhe çdo lloj transformimi tjetër të Shoqërisë;
  - e. të themelojë dhe/ose mbyll degë dhe përfaqësi jashtë dhe brenda Shqipërisë;
  - f. të miratojë raportet vjetore dhe bilancet dhe të miratojë shpërndarjen e fitimit;
  - g. të depozitojë padi kundër anëtarëve të organeve të Shoqërisë;
  - h. të vodosë mbi përvetësimin, shitjen dhe vodosjen e barrës mbi pasuritë;
  - i. të shkrijë Shoqërinë;
  - j. të vodosë pagën e Administratorit;
  - k. të vodosë për caktimin e ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - l. të vodosë mbi organizimin strukturor dhe administrativ të Shoqërisë;
  - m. të vodosë mbi buxhetin vjetor;
  - n. të vodosë marrjen e huave apo dhënien e garancive nga Shoqëria;



---

**Neni 13**  
**Administrimi i Shoqërisë**

- 13.1 Shoqëria do të administrohet nga një administratorë, të emëruar me vendim të Ortakut të Vetëm.
- 13.2 Administratori ka të drejtë të përfaqësojnë Shoqërinë në mënyrë të plotë për administrimin e zakonshëm të saj si edhe të drejtën për të miratuar të gjitha vendimet që i gjykon të përshtatshme pér arritur dhe përbushur qëllimin e shoqërisë, me përashtim të vendimeve që me ligj i takojnë Asamblesë së Ortakut të Vetëm.
- 13.3 Administratori mund të autorizojë palë të treta pér ta përfaqësuar atë në transaksione të veçanta me anë të një prokure të hartuar para noterit.
- 13.4 Të drejtat dhe detyrimet e Administratorit janë ato të përcaktuara në Ligjin e Shoqërive Tregtare, këtë Statut, vendimet e Asamblesë së Ortakut të Vetëm dhe rregullat e brendshme të administrimit të Shoqërisë.
- 13.5 Administratori gëzon të drejtat dhe detyrimet e mëposhtme:
- përfaqësimin e Shoqërisë kundrejt palëve të treta dhe shtetit;
  - hapjen e llogarive bankare të Shoqërisë me bankat;
  - përfundimin e marrëveshjeve me palët e treta, lëshimin dhe marrjen e urdhër pagesave;
  - nënshkrimin e të gjithë dokumenteve, lëshimin e faturave, transferimet në monedhë të huaj, fletë ngarkesat etj, pagimin e detyrimeve të Shoqërisë dhe pranimin e letrave me vlerë nga palët e treta;
  - mbledhjen e detyrimeve që i takojnë shoqërisë, dhënien dhe marrjen e paradhënieve;
  - punësimin dhe shkarkimin e stafit të Shoqërisë, përcaktimin e pagave, shpërblimeve dhe pagesave të stafit;
  - marrjen e masave paraprake pér mbrojtjen e interesave të Shoqërisë, ngritjen e padive dhe marrjen përsipër të mbrojtjes së Shoqërisë në rast të padive kundër saj; administratori mund të udhëzojë avokatët të mbrojnë Shoqërinë dhe mund të përcaktojë shumën e shpërblimit të tyre me miratimin paraprak të Asamblesë së Ortakut të Vetëm;
  - administratori kaë të drejtë të ngrejë padi dhe t'i térheqë ato, të nënshkruajë marrëveshje gjyqësore, të mbylli marrëveshje arbitrazhi, të caktojë arbitra, të térheqë paditë e ngritura nga Shoqëria dhe të ndërpresë procedimet por në cdo rast pérpara kryerjes së ndonjë prej veprimeve të mësipërme, administratori duhet të marrë miratimin e Asamblesë së Ortakut të Vetëm.
  - ndërmarrjen e të gjithë veprimeve të tjera që i takojnë aktivitetit të përditshëm të Shoqërisë nga pikëpamja e ligjit dhe këtij Statuti;
  - mbajtjen e llogarive në përputhje me ligjin dhe parimet e kontabilitetit;
  - përgatitjen e pasqyrave vjetore financiare të Shoqërisë dhe kontrollin e tyre nga auditorë të jashtëm nëse kjo kërkohet nga ligji ose nga një vendim i Asamblesë së Ortakut të Vetëm;

- 
1. të vendosë në dispozicion të Ortakut të Shoqërisë sa herë që të kërkohet prej tij informacionet, raportet dhe dokumentet në lidhje me shpenzimet e Shoqërisë, gjendjen e llogarive bankare, inventarin, deklarata për të hyrat, deklarata tjera financiare, fletëparaqitjet tatimore të Shoqërisë dhe auditet, nëpërmjet formës së kërkuar dhe njoftuara nga Ortaku, si p.sh. nëpërmjet faxit, postës elektronike apo postës së zakonshme.
  - m. kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të Shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
  - n. cdo detyrë tjetër të parashikuar në ligj.
- 13.6 Administratori i Shoqërisë mund të shkarkohet nga pozicioni që ka në Shoqëri në çdo kohë nga Asambleja e Ortakut të Vetëm.
- 13.7 Personi i mëposhtëm do të caktohet si Administrator i Shoqërisë për një afat 5 vjeçar:
1. **ENDRIT SHABANI** shtetas shqiptar, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, lindur më 24 Janar 1988, në Vlorë dhe banues në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i ID-s me Nr. Personal I80124005P.

#### **Neni 14** **Eksperti(ët) Kontabël të Autorizuar**

- 14.1 Eksperti(ët) Kontabël i Autorizuar do të emërohet me vendim të Asamblesë së Ortakut të Vetëm, nëse është e nevojshme.

#### **Neni 15** **Viti Financiar dhe Dividendi**

- 15.1 Viti Financiar i aktivitetit të Shoqërisë përkon me vitin kalendarik, fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti.
- 15.2 Administratori merr masat me qëllim hartimin e bilanceve, rezultateve ekonomike të fitimeve apo humbjeve dhe inventarizimin. Pas analizimit të cështjeve të mësipërme si edhe shlyerjen e detyrimeve, të ardhurat e tjera do ti kalojnë ortakut të shoqërisë.

#### **Neni 16** **Bilanci. Mbajtja e Llogarisë**

- 16.1 Bilanci i Shoqërisë kontrollohet nga Asambleja e Ortakut të Vetëm dhe duhet të përgatitet për t'ju paraqitur organeve tatimore përpëra përfundimit të muajit mars të vitit pasues.



- 
- 16.2 Librat e llogarisë duhet të mbahen në gjuhën shqipe dhe në monedhën vendase (Lek). Shoqëria mund të mbajë llogari të veçanta në monedhë të huaj, shuma e të cilave duhet të konvertohet, çdo muaj, në monedhën vendase.
  - 16.3 Shoqëria mund të marrë financime nga institucione financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë saj. Për këtë arsyesh Shoqëria mund të vendosë barrë siguruese mbi kuotat si garanci, ose mund të hipotekoje pasurinë e paluajtshme të saj, me vendim të Asamblesë së Ortakut të Vetëm.

**Neni 17**  
**Likuidimi**

- 17.1 Në rast se shoqëria shpërndahet për cdo lloj arsyesh Ortaku i vetëm përcakton mënyrën e likuidimit, cakton një likuidues ose një grup likuiduesish që do të merren me procedurat e likuidimit.
- 17.3 Likuiduesi(t) do të përgatisin raportin e likuidimit, i cili përmban një përbledhje të gjendjes ekonomike të Shoqërisë, hapat e likuidimit dhe kohën e nevojshme për përfundimin e tij. Në fund të këtij procesi, Asambleja e Ortakut të Vetëm do të kontrollojë bilancin përfundimtar dhe do të japë miratimin për përfundimin e procedurës së likuidimit.

**Neni 18**  
**Ndryshimet në Statut**

- 18.1 Dispozitat e këtij Statuti mund të ndryshohen nga Asambleja e Ortakut të Vetëm, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

**Neni 19**  
**Dispozita Përfundimtare**

- 19.1 Ky Statut hartohet dhe nënshkruhet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe, secila prej tyre me të njëjtën vlerë ligjore.

**ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE “ENOLIO” SHPK**

ENDRIT SHABANI

*Endrit Shabani*  
*Eny*

*Eny*

---

**AKT THEMELIMI  
I SHOQUERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
“ENOLIO” SHPK**

Sot më datë 30/05/2017, unë i nënshkruari:

- **ENDRIT SHABANI** shtetas shqiptar, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, lindur më 24 Janar 1988, në Vlorë dhe banues në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i ID-s me Nr. Personal I80124005P.

Mbështetur ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, ligjin 9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, hartoj dhe nënshkruaj këtë Akt Themelimi të shoqerisë me përgjegjësi të kufizuar të emëruar **“ENOLIO” SHPK** si me poshte:

**Neni 1  
Krijimi**

1.1 Shoqeria **“ENOLIO” SHPK** është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (me poshte referuar “Shoqëria”).

1.2 Kjo shoqëri është themeluar nga “Ortaku i vetëm i shoqerise”, i cili përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributet e ortakut përbëjnë kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

**Neni 2  
Selia**

2.1 Selia e Shoqerise është: **Njësia Administrative Nr.1, Rruga “Niko Avrami”, Pasuria nr.7/434+2-N, Tiranë.**

2.1 Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës se Shqiperise, me vendim të Ortakut .

**Neni 3  
Objekti i veprimtarisë**

3.1 Prodhimi i energjisë duke perdorur energjine e gjelber si uje, burimet termike, burimet e eres, biogazit dhe fotovoltaikë. Ndertim dhe projektim hidrocentralesh studime te fizibilitetit, planit te bizneseve. Planifikimin, ndertimin, operimin, menaxhimin dhe financimin e furnizimit te decentralizuar te energjise.



---

#### **Neni 4 Kohëzgjatja**

4.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per një periudhe kohore te pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne regjistrin tregtar.

#### **Neni 5 Kapitali themeltar**

- 5.1 Kapitali fillestari i Shoqërisë është 100.000 (njëqindmijë) Lek.
- 5.2 Kapitali i shoqërisë është i ndarë në 1 pjesë (kuotë,) me vlerë nominale 100.000 (njëqind mijë) Lek.
- 5.3 Kuota do të mbahet nga ortaku vetëm, i cili është zotërues i 100 % të kapitalit të Shoqërisë.
- 5.4 Kontributi i ortakut mund te jete ne para ose ne natyre.

#### **Neni 6 Organi Vendimmarrws**

6.1 Organe t e shoqërisë janë:

- 3. Asambleja e Ortakut të Vetëm të Shoqërisë.
- 4. Administratori

6.2 Vendimet kryesore të veprimtarisë së Shoqërisë merren me vendim të Asamblesë së Ortakut, e cila është organi më i lartë i Shoqërisë, që ka të drejtën të miratojë vendime në lidhje me të gjitha çështjet e aktivitetit të saj.

#### **Neni 7 Administrimi**

7.1 Shoqëria do të administrohet nga një administrator, të emëruar me vendim të Ortakut të Vetëm.

7.2 Administratori ka të drejtë të përfaqësojë Shoqérinë në mënyrë të plotë për administrimin e zakonshëm të saj si edhe të drejtën për të miratuar të gjitha vendimet që i gjykon të përshtatshme për të arritur dhe përbushur qëllimin e shoqërisë, me përjashtim të vendimeve që me ligj i takojnë Asamblesë së Ortakut të Vetëm.

7.3 Administratori mund të autorizojë palë të treta për ta përfaqësuar atë në transaksione të veçanta me anë të një prokure të hartuar para noterit.

7.4 Të drejtat dhe detyrimet e Administratorëve janë ato të përcaktuara në Ligjin e Shoqërive Tregtare, në Statut, vendimet e Asamblesë së Ortakut të Vetëm dhe rregullat e brendshme të administrimit të Shoqërisë.

7.5 Administratori i Shoqërisë mund të shkarkohet nga pozicioni që ka në Shoqëri në çdo kohë nga Asambleja e Ortakut të Vetëm.

7.6 Personi i mëposhtëm do të caktohet si Administrator i Shoqërisë për një afat 5 vjeçar:

- 
- **ENDRIT SHABANI** shtetas shqiptar, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, lindur më 24 Janar 1988, në Vlorë dhe banues në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i ID-s me Nr. Personal I80124005P.

### **Neni 8 Viti Financiar**

8.1 Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

8.1 Administratori merr masat me qëllim hartimin e bilanceve, rezultateve ekonomike të fitimeve apo humbjeve dhe inventarizimin. Pas analizimit të cështjeve të mësipërme si edhe shlyerjen e detyrimeve, të ardhurat e tjera do ti kalojnë ortakut të shoqërisë.

### **Neni 9 Eksperti(ët) Kontabël të Autorizuar**

9.1 Eksperti(ët) Kontabël i Autorizuar do të emërohet me vendim të Asamblesë së Ortakut të Vetëm, nëse është e nevojshme.

### **Neni 10 Likuidimi**

10.1 Në rast se shoqëria shpérndahet për cdo lloj arsyec Ortaku i vetëm përcakton mënyrën e likuidimit, cakton një likuidues ose një grup likuiduesish që do të merren me procedurat e likuidimit.

10.2 Likuiduesi(t) do të përgatisin raportin e likuidimit, i cili përmban një përbledhje të gjendjes ekonomike të Shoqërisë, hapat e likuidimit dhe kohën e nevojshme përfundimin e tij. Në fund të këtij procesi, Asambleja e Ortakut të Vetëm do të kontrollojë bilancin përfundimtar dhe do të japë miratimin përfundimin e procedurës së likuidimit.

### **Neni 11 Baza Ligjore**

11.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj në perputhje te plete me statutin dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

---

**Neni 12**  
**Mosmarreveshjet**


12.1 Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

**Neni 13**  
**Dispozita perfundimtare**

13.1 Ky Akt Themelimi u redaktua ne 2 kopje me permbytje dhe vlera te njejtave juridike, ne gjuhen shqipe, u miratua ne parim nen per nen nga Ortaku i shoqerise tregtare “ENOLIO” SHPK, nenshkruehet ne te gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen orgjinale.

**ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE “ENOLIO” SHPK**

**ENDRIT SHABANI**

A handwritten signature in black ink, appearing to read "Endrit Shabani". Below the signature, there is a stylized, cursive mark or initial that looks like "SY".